

MUNDËSITË E ZHVILLIMIT TË TURIZMIT PËRMES AKTIVITETEVE REKREATIVO SPORTIVE

*Dr.Bujar Turjaka, prof.asoc
bujarturjaka@gmail.com*

Abstrakt

Paraqitja e rekreacionit sportiv ka rrjedhë si pasojë e zhvillimit të shoqërisë dhe ekonomisë. Procesi i përsosur teknologjik ka ndikuar me të madhe në karakterin e punës, kushteve të punës, medisit punues dhe mënyrës së jetesës. Ndryshimet në karakterin e punës, llojin dhe intenzitetin e ngarkesave gjatë punës, janë të kushtëzuara para së gjithash me aplikimin e procesit bashkëkohor teknologjik, automatizimit dhe kibernetizimit të prodhimit. Në turizëm, rekreacioni sportiv ka një rendësi të madhe si në shoqëri që është i domosdoshëm po ashtu edhe në funksionin e argëtimit dhe dëfrimit dhe shpenzimit të kohës së lirë ku përmes këtyre rrugëve krijohen rezultate në arritjen e interesit të përfuturit nga ana financiare dhe turistike për shtetin që investon për këtë lami. Turizmi dhe rekreacioni sportiv janë përmbajtje të rëndësishme të kohës së lirë dhe si të tilla duhet trajtuar pasi ndikimi i tyre ka efekte shumë pozitive në jetesën bashkohore.

Fjalët kyqe: Rekreacioni, turizmi, koha e lirë, pushimi aktiv, sporti, stresi,

JEL Klasifikimi: L83

Hyrje

Është e pakontestueshme se turizmi përbën dukurinë më të madhe sociale të këtij shekulli. Edhe pse e ka traditën e vetë, zhvillimi i tij qysh në shekullin e XX-të përjeton ekspansion të jashtëzakonshëm. Për çdo ditë turizmi bëhet “artikull i kërkesave masovike”.

Në faktorët të cilët kanë ndikuar në zhvillimin e hovshëm të turizmit, lajmërohet edhe fenomeni tjetër i quajtur “sport”, i cili në kuptimin e gjërë të fjalës mendohet në lëmin e rekreacionit sportiv e cila mbetet si nevojë e njeriut bashkëkohor për lëvizje si pasojë e industrializimit dhe urbanizimit.

Derisa sporti klasik përfaqëson turizmin, shtyrjen për udhëtim me qëllim të përcjelljes së shfaqjeve, rekreacioni sportiv paraqet angazhim aktiv të njerëzve në kryerjen e aktiviteteve rekreative dhe si i tillë mbetet gjithnjë e më shumë pjesë përbërëse e kërkesave turistike.

1. Faktorët të cilët ndikojnë në zhvillimin e rekreacionit sportiv në turizëm

Në bazë të shumë hulumtimeve të realizuara deri me tani është konstatuar se këto dukuri janë në raporte shumë të ngushta dhe reciproke. Në bazë të hulumtimeve të shumta në sport dhe rekreacionin sportiv shumë lehtë mund të vertetohet dhe konstatohet mbi ndikimin dhe rolin e aktiviteteve rekreative sportive në kërkesat dhe ofertat turistike.

Egziston një numër i madh faktorësh të cilët ndikojnë dhe kushtëzojnë aktivitetet rekreative në turizëm, mirëpo ndër faktorët kryesor janë:

- Rritja e kërkesave rekreative – sportive, të cilat shfaqen si pasojë e mënyrës bashkohore të jetësës dhe punës
- Rritja e fondit të kohës së lirë si faktor i zhvillimit të rekreacionit sportiv në turizëm
- Rritja e standardit (të ardhurave) të popullatës si faktor i zhvillimit të rekreacionit sportiv në turizëm

2. Turizmi dhe rekreacioni sportiv

Rekreacioni sportiv ne turizëm është një faktor i domosdoshëm dhe i nevojshëm në kënaqjen e dëshirave dhe nevojave të njeriut për loje, për dalje ne diell, ujë, borë si dhe ka rendësin e vet psiko-fiziologjike. Pra, sporti ne turizëm mund te definohet si aktivitet edukativ-mësimor në kënaqjen, dëfrimin e popullatës në aspektin e aktiviteteve lëvizore – rekreative – sportive, qe është pjese e shkollimit te gjeneratave te reja. Në aspektin rekreativ ka për qëllim përmbushjen e nevojave te kënaqjes se njeriut me lëvizje, loje, aktivitete, qe e bëjnë dhe e forcojnë apo mbajnë me tutje organizmin vital te njeriut si nga ana fizike po ashtu edhe ajo psikike e mentale. Sporti dhe turizmi janë të lidhura ngushtë si pasoj lëvizjes së njerëzve ne vende të ndryshme, janë motivet e mundshme që të përcillen ndodhitë e ndryshme sportive, garuese, manifestuese, si: lojërat olimpike, botërore, evropiane etj. Aktivitetet sportive kanë ndikim ne turizëm si në vend-pushime, ku njerëzit luajnë tenis, skijojnë, luajnë golf, kalërojnë etj.

Rekreacioni sportiv ne turizëm ka rendësin dhe efektin e çlodhjes së organizmit te njeriut, ku lëshon vendin e punës dhe te qëndrimit duke ndërruar një vend tjetër me pushim ne det apo vend malor për tu relaksuar çoftë për vikend apo pushim. Është konstatuar qe pushimi aktiv me shpejt e sjell njeriun ne procesin e pushim te organizmit, ne krahasim me pushimin pasiv apo te qetësisë. Personat që merren me rekreacion sportiv qoftë në moshën e re apo të vjetër mund te kenë shume interes për arsye se ndalojnë sëmundjet moderne si ato kardiovaskulare, nervore, te stërkeqjes se muskujve, organizmit etj.

Rekreacioni sportiv jo vetëm qe bën dukjen e mire dhe mbajtjen e drejt te trupit, por ndikon edhe ne mbarëvajtjen e mirë të aftësive funksionale në nivel të lart. Rekreacioni dhe njeriu gjithmonë është ne kontakt me ajrin, diellin, ujin, borën, pajisjet sportive duke mundësuar turizëm efikas dhe këto aktivitete mund te quhen ndryshe edhe "ilaç i njeriut".

Rekreacioni sportiv ka një rëndësi të madhe në marrëdhënie me zhvillimin e turizmit bashkëkohor. Mysafiret e shumtë qe vijnë ne qendra turistike që kanë

fusha golfi, futbollit, volejbollit, basketbollit, kalërimi, skijimi etj, rrisin edhe më shumë rëndësinë e rekreacionit në turizëm.

Në turizëm përpos kënaqjes së mysafireve gjatë pushimeve, aktivitetet rekreative në turizëm kanë edhe rëndësinë ekonomike:

- efektin direkt financiar, pagesën e shërbimit në qendrat rekreative-sportive.
- rrugëve indirekte të lehta dhe të shpejta rreth shitjes së kapaciteteve, shitjes së pajisjeve, pijeve dhe rekuizitave, benzinës dhe gjërave tjera.

2. Mundësitë e zhvillimit të turizmit përmes formave stacionare të aktiviteteve rekreative

Në kuadër të formave stacionare të aktiviteteve rekreative bëjnë pjesë:

Pushimi aktiv gjatë vikendit

Janë forma të aktiviteteve jashtë vendbanimit të cilat kanë për qëllim largimin e lodhjes akute dhe kronike si pasojë e ngarkesave gjatë punës. Kjo formë e aktiviteteve realizohet gjatë ditëve jo pune (vikend) në ndonjë prej qendrave turistike të cilat ofrojnë qëndrim dhe përmbajtje rekreativo-sportive.

Pushimi aktiv gjatë pushimit vjetor

Janë forma të aktiviteteve me qëndrim më të gjatë të pjesëmarrësve jashtë vendbanimit në ndonjë nga qendrat në të cilat gjatë kohës së qëndrimit realizohen programe rekreativo-sportive me qëllim të argëtimit, freskimit, këndelljes, dëfrimit etj. Në kuadër të pushimeve aktive gjatë pushimit vjetor mund të organizohen këto përmbajtje:

- Gara familjare (bowling, pikado, mini golf)
- Gara sportive (individuale ose kolektive)
- Mësim i fillestarëve (not, tenis, surfing, ski në ujë)
- Aktivitete tjera të cilat mund të organizohen jashtë qendrës turistike (shetitë, orientimet, kalërimi).

Aktivitetet shoqëroro-zbavitëse

Segment i rëndësishëm në kuadër të realizimit të suksesshmëm dhe efekteve më të mëdha të pushimeve aktive janë aktivitetet shoqëroro-zbavitëse. Këto aktivitete realizohen çdo ditë në kuadër të këtyre pushimeve në kohëzgjatje 60-90 minuta dhe lëjnë gjurmë pozitive në aspektin emocional dhe argëtues. Këto aktivitete janë:

- Tombolla
- Kuizi
- Turniret
- Maskenballi
- Lojëra shoqërore
- Llotaria (lojëra fati).

Aplikimi i ketyre aktiviteteve të programuara rekreative ndikojnë në:

- rritjen e shkallës së shëndetit
- humanizimit të raporteve ndërnjerzore
- kalimit të kohës së lirë në mënyrë kualitative

3. Rekreacioni si mënyrë bashkohore e jetesës

Njeriu bashkëkohor shumë shpesh përdor fjalën rekreacion, zakonisht për ndonjë aktivitet jo obligativ i cili ofron ndjenjën e kënaqësisë, relaksimit dhe zbavitjes. Vet termi ka kuptimin se bëhet fjalë për aktivitetet të cilat nuk janë të imponuara dhe të cilat pozitivisht ndikojnë në shëndetin psikofizik të njeriut, zhvillimin e kreativitetit, shoqërimit, edukimit etj. Rekreacioni sportiv në përbajtje të vet ka aktivitete sportive që përpos kënaqësisë mund të kenë edhe një varg të faktorëve pozitiv të cilët ndikojnë në gjendjen e përgjithshme shëndetësore të njeriut gjë që pasuron dhe begaton botën në të cilën jetojmë. Në rekreacionin sportiv nuk ka seleksionim si të sportet aktive-garuese dhe as rezultatet nuk janë primare si në sport (aktiv e garues). Rekreacioni zhvillon aftësitë psiko-fizike dhe shëndetin shpirtëror, ndërsa sporti (aktiv-garues) i cili jo vetëm që zhvillon dhe perfeksionon këto, por edhe aftësitë tjera specifiko-psiko-fizike me qëllim të arritjes së rezultateve sa më të mëdha në sport.

Pra, te sporti rezultati është primar për dallim me aktivitetet rekreative ku rezultati është sekondar dhe më e rëndësishme është mbajtja e aftësive të njëjta si dhe shëndrimi në aktivitete qetësuese-relaksuese-freskuese e shpirtërore duke eliminuar edhe stresin. Rekreacioni ose sporti për te gjithë (sports for all), mbledh dhe angazhon te gjithë ata qe kane dhe ndiejnë nevojë te merren me ushtrime, lojëra apo lëvizje trupore, pa dallim moshe dhe gjinie.

Me këtë aktivitet janë poashtu te organizuar dhe merren punëtorët ne organizatat punuese, qytetaret ne vendet e ndryshme sportive-rekreative. Rekreacioni nuk është i organizuar si federatat, por ka respektim të rregullave të lojës, këto rregulla nuk janë të ashpra si te sporti aktiv-garues dhe profesional.

Konkluzion

Pushimi aktiv në kohën e lirë, në të vërtetë angazhimi me ndonjë sport dita ditës është nevojë e njeriut bashkëkohor. Vetëm përmes angazhimit dhe aktivitetit personal, qoftë nëse flasim për shetitë në natyrë, lundrim apo bjeshkatari, njeriu mund të realizoj përjetim të plotë dhe kontakt me natyrën e cila i mungon aq shumë. Të ushtruarit e drejtë dhe me rregull mund të ndikoj pozitivisht në shumë funksione të organizimit të cilat bazohen në veprimin e katër grupeve të karakterisitikave (aftësitë funksionale, aftësitë motorike, aftësitë morfologjike dhe karakteristikat psikosociale) të cilat në mënyrë të barabartë ndikojnë në shëndet. Si pasojë e moslëvizshmërisë dhe plakjes pason dobësimi i organizimit, rezistenca dhe aftësia e

tij i përshtatet kushteve të jetës dhe të punës, prandaj në këtë mënyrë keqësohet gjendja shëndetësore.

Duke pas parasysh gjitha këto të dhëna dhe ambientin e shkatëruar dhe të ndotur në masë të madhe (ajëri i papastër, prezenca e kemikalieve, zhurma) mund të themi se rekreacioni është produkt i nevojës së shoqërisë pasi që si pasojë e moslëvizshmërisë vërejtet deri te problemet shëndetësore dhe sëmundjet të cilat janë të kushtëzuara nga mënyra bashkohore e jetesës.

Referencat

1. Grup autorësh (2002) Sportska rekreacija, Sarajevë
2. M. Andrijasevic (2000), Rekreacijom do zdravlja i ljepote, Zagreb
3. M. Andrijasevic (1996), Sportska rekreacija u mestu rada i stanovanja, Zagreb
4. Mrakovic, S i O. Mojzez: Trzisni aspekti sportske rekreacije u turizmu, Zagreb 1972

